



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 164 / 5 Prot.

Tiranë më 17.07.2020

REKOMANDIM

Nr. 13, datë 17.07.2020

PËR KONTROLLUESIN "ALBCHROME" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim "*Ligji*"), ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim "*Kodi i Procedurave Administrative*"), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Albchrome*" SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 24 datë 11.02.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Albchrome*" SHPK (në vijim, "*Kontrolluesi*"), me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi B.GJ, si dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Hetimi administrativ, pranë kontrolluesit, u fokusua në:

- (i) trajtimin e ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një subjekt i të dhënave personale (ish punonjës i Kontrolluesit), i cili pretendonte se Kontrolluesi kishte publikuar në llogarinë e tij në rrjetin shoqëror "*facebook*", listëpagesat me të dhënat e subjektit të të dhënave në fjalë, pa marrë më parë pëlqimin e këtij të fundit, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit; dhe
- (ii) verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi ka publikuar në llogarinë e tij në rrjetin shoqëror *"facebook"*, me datë 11.01.2020, ora 17:09, fotografi të disa listëpagesave, të cilat përmbajnë të dhëna personale të disa ish-punonjësve të tij, të tilla si: emër, mbiemër, paga bruto dhe neto për secilin prej tyre.
2. Referuar deklarimeve të përfaqësuesve të Kontrolluesit, rezulton se të dhënat e publikuara në *"facebook"* janë marrë nga faqja e Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (në vijim, *"FSPISH"*) dhe më pas, janë publikuar/shpërndarë edhe në llogarinë *"facebook"* të vetë Kontrolluesit.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar një kontratë kolektive pune me FSPISH. Pjesë e kësaj kontrate është edhe tabela e pagave për profesionet specifike në minierën e Bulqizës, por në të cilën parashikohen vlera referuese. Ndërkohë, të dhënat për pagat, të publikuara në *"facebook"*, tregojnë vlera specifike të përfituara nga ankuesi, si punonjës i Kontrolluesit.
4. Referuar datës dhe orës së publikimeve të të dhënave personale në *"facebook"*, rezulton se burimi i marrjes së tyre është faqja e FSPISH. Megjithatë, publikimi i tyre nga ana e Kontrolluesit përbën shkelje, pasi konsiderohet përhapje e paligjshme e të dhënave personale, në kundërshtim me detyrimet e parashikuara në nenet 5 dhe 6, të Ligjit.

Zyra e Komisioneri vlerëson se, pavarësisht kohës dhe mënyrës së publikimit, apo qëllimit për mbrojtjen e interesit të tij në raport me të tretë, Kontrolluesi duhet të respektojë parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale, parashikuara në nenet 5 dhe 6, të Ligjit.

5. Provat e paraqitura nga ana e Kontrolluesit nuk vërtetojnë plotësimin e kriterëve ligjore të përpunimit, në kuadër të legjitimitetit të përhapjes së të dhënave personale në lidhje me marrjen e pëlqimit paraprak të subjekteve të të dhënave, në kundërshtim me parashikimet e nenit 6, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, marrja e pëlqimit është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar germës a), të pikës 1, të nenit 6, të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të pikës 24, të nenit 3, të Ligjit duhet të jetë në formën e një deklaratë me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë nga subjekti i të dhënave, duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çfarë nënkupton se subjekti i të dhënave pranon që të dhënat e tij të përpunohen.

Për sa kohë Kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit të ankuesit për publikimin e të dhënave të tij, vlerësojmë se përpunimi i të dhënave cenon edhe parimin e sanksionuar në germën a), të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

6. Kategoritë e të dhënave personale të ankuesit, të cilat janë publikuar, janë mbledhur dhe përpunuar nga ana e Kontrolluesit në cilësinë e punëdhënësit, për qëllime punësimi. Në këtë kuadër, pavarësisht faktit se të dhënat rezultojnë të jenë përhapur për herë të parë nga ana e FSPISH, është përgjegjësi e Kontrolluesit që të marrë masat e nevojshme dhe të mjaftueshme të sigurisë dhe konfidencialitetit me qëllim shmangien e aksesit dhe përhapjes nga persona ose subjekte të tjera të paautorizuara, në zbatim të neneve 27 dhe 28, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi, në cilësinë e punëdhënësit është përgjegjës për të garantuar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale, në rastin konkret të punonjësve, duke hartuar politika dhe rregulla specifike mbi aksesin, ruajtjen fizike dhe teknike të të dhënave (në varësi të formës së administrimit të tyre), konfidencialitetin nëpërmjet nënshkrimit të deklaratave të konfidencialitetit në lidhje me përhapjen e të dhënave personale, për secilin prej punonjësve që kanë akses në të dhëna dhe janë pjesë e proceseve përpunuese, duke garantuar edhe gjurmueshmërinë e tyre, si dhe masa të tjera në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

7. Kontrolluesi ka hartuar një rregullore të brendshme "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", në zbatim të nenit 27, të Ligjit. Kjo rregullore ka karakter të përgjithshëm dhe nuk parashikon rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të administrimit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënies së punës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, rregullorja e brendshme "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", duhet të parashikojë masa specifike dhe konkrete për çdo proces përpunimi që kryen kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Kjo, pasi masat në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale ndryshojnë në varësi të qëllimit të përpunimit, kategorive të të dhënave personale që përpunohen, kriterëve ligjore të përpunimit, kategorive të subjekteve të dhënat e të cilëve përpunohen dhe faktorë të tjerë.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/1"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Albchrome" SHPK, të realizojë në mënyrë të menjëhershme fshirjen e të dhënave personale të ankuesit, të publikuara në llogarinë e tij në rrjetin shoqëror "facebook", si dhe çdo platformë tjetër të kësaj natyre.
2. Kontrolluesi "Albchrome" SHPK, në zbatim të nenit 27, të Ligjit, të marrë masa për të përditësuar rregulloren e brendshme "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", duke parashikuar rregulla specifike për mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen në kuadër të administrimit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të marrë masat e nevojshme dhe të mjaftueshme të sigurisë dhe konfidencialitetit me qëllim shmangien e aksesit dhe përhapjes nga persona ose subjekte të tjera të paautorizuara, në zbatim të neneve 27 dhe 28, të Ligjit.

3. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

(i) menjëherë, detyrimin e parashikuar në pikën 1, më sipër;

(ii) brenda 30 ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 2, më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

4. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39, të Ligjit të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17.07.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

